

DOKUMENTI KONSULTATIV

Për draftin e ligjit titulli i projektligjit: Për Bankën Shqiptare të Zhvillimit.

- *Komente (të përgjithshme) publike;*
- *Komente nga organizatat joqeveritare (me fokus biznesin);*
- *Komente nga dhomat e biznesit;*
- *Komente nga korporatat dhe bizneset e mëdha të cilat operojnë në Shqipëri;*
- *Komente nga akademia (pedagogë, studentë, etj.).*

Kohëzgjatja e konsultimeve:

Konsultimi publik nëpërmjet publikimit në RENJKP do të zgjasë 20 (njëzet) dite pune nga data e njoftimit për procesin e konsultimit publik dhe përkatësisht, nga data 24 Janar deri në datë 21 Shkurt.

Si të përgjigjeni:

Përgjigjet mblidhen përmes këtyre mënyrave:

Duke plotësuar formularin online në RENJKP.

Mbledhja e komenteve të dhëna në postën elektronike/e-mail në: info@sipermarrja.gov.al

Me postë në: Ministri i Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit.

Adresa: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 1, Tiranë 1001, Shqipëri.

Kontakti:

Ina Buli

Ina.Buli@kek.gov.al

Fjorind Lika

Fjorind.Lika@sipermarrja.gov.al (koordinator)

Datat dhe vendet e takimeve publike:

Takimet dhe tryezat publike do të organizohen tek Shtëpia e Biznesit, pranë Piramidës.

Sfondi i propozimit legjislativ:

Qëllimi i këtij projektligji është krijimi dhe funksionimi i Bankës Shqiptare të Zhvillimit, një institucion financiar zhvillimi i ngjashëm me Bankat Kombëtare Promovuese në Bashkimin Evropian. Institucioni synon të mbështesë zhvillimin ekonomik dhe social të vendit përmes lehtësimit të qasjes në financime për sektorët e nënfinancuar, me fokus të veçantë tek ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, si dhe projektet që përmirësojnë infrastrukturën fizike dhe digjitale. Projektligji synon të adresojë dështimet e tregut që pengojnë financimin dhe investimet e nevojshme për një rritje më të shpejtë dhe të qëndrueshme. Funksionet e parashikuara të Bankës përfshijnë ofrimin e financimeve, dhënien e garancive, dhe promovimin e eksporteve, duke siguruar kështu një ndikim të gjerë dhe të qëndrueshëm për ekonominë shqiptare. Veprimtaria e saj do të bazohet në parimet e transparencës dhe llogaridhënies, duke respektuar legjislacionin për ndihmën shtetërore dhe konkurrencën.

Propozimet:

Objektivat kryesore të këtij institucioni, të cilat janë objektivat promovuese, janë hartuar në mënyrë që të krijojnë një ndikim të gjerë dhe të qëndrueshëm, siç vijon më poshtë:

1. Mbështetja e Sipërmarrjeve Shqiptare

IFZH synon të fuqizojë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NMV) dhe startup-et, duke ofruar financim dhe, sipas rastit mbështetje teknike, për të ndihmuar këto biznese të përmirësojnë produktivitetin, të rrisin konkurrueshmërinë dhe të zgjerojnë prezencën e tyre në tregjet ndërkombëtare.

2. Promovimi i Eksporteve

Një nga objektivat e BZH, që gjendet edhe në një sërë institucionesh të ngjashme europiane, është mbështetja e eksporteve shqiptare duke inkurajuar prodhimin dhe shërbimet që mund të konkurrojnë me sukses në tregjet jashtë vendit.

3. Mbështetja e projekteve me rëndësi për zhvillimin ekonomik

BZH mbështet financimin e projekteve publike, në nivel qendror dhe vendor, që kanë përparësi në ekonominë e vendit. Në këtë kuadër, do të veprojë kryesisht në rolin e ndërmjesisit financiar duke kanalizuar fonde apo linja financimi nga insitucionet financiare ndërkombëtare, ato europiane apo partnerë të tjerë zhvillimi

4. Zhvillimi i Infrastrukturës Fizike dhe Digjitale

Një nga objektivat do të jetë gjithashtu mbështetja e zhvillimit, përmirësimit dhe modernizimit të infrastrukturës fizike dhe digjitale, në përputhje me objektivat strategjike kombëtare, për të nxitur një ekonomi të qëndrueshme dhe të orientuar drejt teknologjisë.

Pyetjet:

- Cili do të ishte ndikimi i krijimit të Bankës Shqiptare të Zhvillimit në aksesin tuaj ndaj financimit për zhvillimin dhe zgjerimin e veprimtarisë suaj të biznesit?